




DPK/OMP  
02

03-3595/13  
29.10.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / OSNOVNI SUD ĐAKOVICA**  
Divizioni i kundërvajtjes  
**Nr.regj.04-480/2011**

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- DEPERTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, si gjykatë e shkallës së parë, me gjykatësen Diana Sina-Baraku, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse, kundër të pandehurës, Samile Gani Pasha, nga Gjakova . Për shkak të veprës kundërvajtëse nga lëmi i inspeksionit , e në bazë të nenit 73,74,195,198 al 1 pika 7 dhe neni 27 al 4 të Ligjit mbi kundërvajtjet. Me datën 30.09.2013, Gjykata mori këtë

**AKTVENDIM**

PEZULLOHET kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës , Samile Gani Pasha, e lindur më datën 16.01.1949, nga Gjakova Rr “Orize jugore” , se ka ardhur deri të parashkrimi absolut i kësaj kundërvajtje.

Konform nenit 198.al 1 pika 7 të L M K-së.

**ARSYETIM**

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër korrupsionit në Prishtinë ,nr 01-3237/2011, të datës 12.07.2011 ,është filluar procedura kundërvajtëse , kundër të pandehurit, Samile Gani Pasha , për shkak të kundërvajtjes nga lëmi i inspeksionit.

Gjykata me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, konstatoi se edhe pas ndërmarrjes së veprimeve nga kjo gjykatë, shihet se ka ardhur deri të parashkrimi absolut i ndjekjes më datën **30.09.2013**, për shkak se vepra kundërvajtëse është kryer më datën **12.07.2011**, në këtë rast kanë kaluar dy vite nga data kur është kryer kundërvajtja dhe për këtë arsye ka ardhur gjerë të parashkrimi absolut, andaj konform nenit 27 alineja 4 të LMK-së.

Duke u bazuar në parashtrimet e më sipërme , Gjykata konform nenit 198 alineja 1 pika 7te Ligjit mbi Kundërvajtjet. Pezullohet procedura për shkak të parashkrimit absolut.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- DEPERTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES.

Nr.regj.04-480/2011, të datës 30.09.2013



GJYKATËSJA,  
DIANA SINA- BARAKU.

03-3595/13/02  
fuz

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktvendimi dhe këtë Gjykatës së Apelit në Prishtinë- Departamentit të përgjithshëm- Divizionit të kundërvajtjes, e nëpërmes kësaj gjykate.